



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep.	2-0/DPK
Nr Prot. Bi Prot. Prot No.	01-3393/14
Data Datumi Date	26.09.2014
PRISHTINE	

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	26.09.2014
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.K.
PËR/ZA/TO:	z. Irfan Veseli, Kryetar i Parlamentit te Studenteve të Universitetit të Prishtinës
Cc:	Parlamentit të Studenteve të Universitetit të Prishtinës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni – <i>Hasan Preteni</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion - Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Konfliktin e Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik

I nderuar z. Veseli

Mbështetur në nenin 5 paragrafi 1 pika 1.12 të Ligjit 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit dhe nenit 19 paragrafi 1 pika 1.5 dhe 1.6 të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik, lidhur me kërkesën tuaj të dt. 05.09.2014, me të cilën keni kërkuar shqyrtimin e vendimit të Këshillit drejtues të UP-së “Hasan Prishtina” për zgjedhjen e rektorit të UP-së “Hasan Prishtina”, nëse zgjedhja e tij, në mbledhjen e mbajtur të Këshillit Drejtues të UP-së “Hasan Prishtina”, të dt. 02.09.2014, a paraqet konfliktit të interesit si shkelje e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, përfaktin se një anëtarë i Këshillit Drejtues të UP-së “Hasan Prishtina”, përkatësisht z. Blerim Kamberi i cili ka marrë pjesë në votim, është burri i motrës së gruas (baxhanaku) i Rektorit të zgjedhur, me dt. 22.09.2014, ju njoftojmë se: në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korruptionit (AKK) lidhur me konfliktin e interesit, sipas

Faqe 1 nga 4



Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; "bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave", si dhe ofron opiniione dhe ndërmerr të gjitha masat tjera ligjore me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit dhe te korruptionit në tërsësi. (Neni 19, pika 1.5, dhe 1.6 te Ligjit Nr.04/L-051).

Andaj bazuar në pyetjen tuaj konkrete që është drejtuar nga ju, si dhe pas analizimit të procesit dhe fakteve Agjencia kundër Korrupsionit ofron ketë:

OPINION

Burri i motrës se gruas (baxhanaku), nuk cilësohet si i afërt me zyrtarin, dhe nuk mund të quhet si person i afërt me zyrtarin, pasi që Ligji për Parandalimin e Konfliktit te Interesit (Nr.04/L-051) nuk e njeh si kategori ligjore që hyn në afërsi me zyrtarin e lart.

Bazuar në Nenin 4 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, z. Blerim Kamberi në cilësinë e Anëtarit të Këshillit Drejtues të UP-së, nuk bën pjesë në listën e kategorizuar të zyrtarëve të lart publik dhe nuk i nënshtrohet termit si Zyrtarë i lartë publik në kontekst të Ligjit në fjalë. Kjo përfaktin se z Kamberi është anëtar i Këshillit Drejtues të UP-së i deleguar nga Senati i Universitetit. Si rrjetohojë dispozitat e Ligjit Nr.04/L-051, nuk e kanë përcaktuar si te tillë. Por ky ligj ka përcaktuar, parime, detyrime, kufizime dhe rregulla të detyrueshme të cilat i referohen zyrtarit të lartë publik dhe në këtë rast nuk mund të aplikohen për zyrtarin në fjalë për arsyet e cekura më lartë.

Sipas Kodit Penal të Republikës se Kosovës, burri i motrës së gruas (baxhanaku), nuk është cilësuar se mund te jetë personi i cili mund të shkaktoj veprën penale të Konfliktit te Interesit, pasi që nuk hyn në listën e personave të afërsisë familjare me zyrtarin e caktuar sipas nenit 424 të këtij kodit.

ARSYETIM

Bazuar në qëllimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik thuhet qartë se: - "qëllimi i ligjit është parandalimi ndërmjet interesit privat të zyrtarëve të lartë në ushtrim të funksionit publik".

Për tu cilësuar një veprim ose një situate si Konflikt i Interesit duhet ti përbaj elementet e përcaktuar me Nacionin e konfliktit të interesit i cili thotë se: - "Konflikti i Interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai

ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Po ashtu, mbështetur në Nenin 3 pika 1.4 e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit, Person i afërt me zyrtarin e lart publik janë: - bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adaptuesi, i adaptuari, në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë. Ndërsa edhe në nenin 4 janë përcaktuar se kush është zyrtar i lartë.

Ekzistimi i rrethanës së konfirmuar në procesin e zgjedhjes se Rektorit të UP-së në mes të z. Kamberi si burri i motrës së gruas (baxhanaku) i Rektorit të zgjedhur të UP-së "Hasan Prishtina", sipas legjislacionit i cili përcakton afërsinë në mes të personave, është konstatuar si rrethanë e cila nuk është e ndaluar apo sanksionuar me normat dhe ligjet në fuqi.

Andaj pjesëmarrja e z. Kamberi si anëtarë i Këshillit Drejtues të UP-së "Hasan Prishtina" në këtë votim nuk është e ndaluar ngase nuk është paraparë ndonjë ndales apo sanksion lidhur me këtë veprim.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të siguruar nga Agjencia, lidhur me këtë proces, është qartësuar se: Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina, si organ i UP-së "Hasan Prishtina, sipas Statutit të UP-së përbëhet prej 9 (nëntë) anëtarëve, ku katër anëtar emërohen nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa 5 (pesë), anëtar emërohen nga senati me mandat 3 (tre) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

Sipas definicionit të konfliktit të interesit ne nenin 424 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082, Konflikti i Interesit është sanksionuar si vepër penale dhe hyn ne kuadër të veprave penale kundër detyrës zyrtare, ndërsa paragrafi 32 i nenit 120 të po këtij kodi, burrin e motrës se gruas(baxhanaku) nuk e kualifikon si personi të afërt te familjes me zyrtarin.

Në këtë rast sipas Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, duke i'u referuar nenit 4 i cili në kuptim të këtij ligji përcakton zyrtarët e lartë, vetëm anëtarët e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina të emëruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë kualifikohen si të tillë, (Zyrtarë të Lartë Publik). Mbështetur në dokumentacionin zyrtar është konfirmuar se z. Kamberi është emëruar nga Senati i UP-së, dhe si i tillë nuk i nënshtrohet përcaktimit si zyrtarë i lartë publik sipas këtij ligji.

Duke e vlerësuar me konsideratë angazhimin tuaj lidhur me procesin e zgjedhjes së Rektorit të UP-se, dhe bashkëpunimin me Agjencinë kundër Korruptionit, konsiderojmë se ne ketë rast nuk kemi elemente të mjaftueshme që mundë të cilësohet si konflikt faktik i interesit të një zyrtari të lart te alduar nga ana juaj. Njëherit për informimin tuaj dhe të publikut duhet thënë se zyrtaret publikë kanë interesa legitime që lindin nga të çenurit e tyre qytetarë te rëndomtë. Mirëpo siç është thënë edhe me lartë për t'u cilësuar një gjendje si Konflikt i Interesit, duhet të ketë elemente që janë të përkufizuara në ligjet në fuqi dhe që e përcaktojnë gjendjen e Konfliktit te Interesit, si dhe lidhjet apo rrethanat që e përcaktojnë këtë gjendje të jene te

përcaktuara, ndërsa pastaj duhet të identifikohet të vlerësohet, të menaxhohet dhe nëse ka elemente duhet te shmanget menjëherë nga zyrtari situata e konfliktit të interesit.

Kësisoj kur është fjala për zyrtarët e lart dhe çdo zyrtar publik duhet ditur se gjatë vendimmarjes së caktuar kanë për detyrë edhe nëse është në dyshim për ekzistencën apo jo të një konflikti interesit të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me udhëheqësin e drejtpërdrejtë apo organin udhëheqës (8.2 LPKI), ndërsa udhëheqësi apo institucioni udhëheqës nëse nuk është i bindur për ekzistimin e konfliktit të interesit apo dyshon se edhe ai ka ose mund të ketë konflikt të interesit atëherë i drejtohet AKK-së, për marrje të vendimit për rastin.

Duke vlerësuar se procesi për zgjedhjen e Rektorit është debatuar dhe është diskutuar në publik, institucioni i Rektoratit do të kish qen mire që për të mos lenë hapësirë që publiku të jap interpretim të ndryshme, ti drejtohet AKK-së që ta vlerësoj dhe të jap një opinion lidhur me ketë çështje. Ndërsa duhet thënë se UP, është i obliguar që te zbatoj ligjet dhe rregulloret për të pas zbatueshmëri dhe respektim të ligjeve në fuqi.

AKK si organ kompetent për trajtimin e Konfliktit te Interesit ka vlerësuar vendimin e Këshillit Drejtues të UP-së "Hasan Prishtina" lidhur me zgjedhjen e Rektorit te UP-së, dhe mund të konstatojmë me përgjegjësi se nuk ka elemente te mjaftueshme që mundë të cilësohet si konflikt faktik i interesit i paraparë me ligjit në fuqi.

Për Informacionin tuaj Statuti i Universitetit të Prishtinës në nenin 189 ka përcaktuar mënyrën e paraqitjes se ankesave ndaj vendimeve të marra nga Organet e Universitetit të Prishtinës.

Me respekt,